

Emri i Lëndës : Media Sociale							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
MUL 213	B	Vjeshtë	2.00	0.00	0.00	1.50	3.00
Lektori		Erlis Çela, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti		Melsena Danglli, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program Profesional 2-Vjeçar					
Përshkrimi		Mediat sociale janë pjesë e pandarë e epokës që po jetojmë. Kjo lëndë shtjellon konceptet për mediat sociale dhe rëndësinë praktike të përdorimit profesional të tyre. Kjo lëndë fokusohet jo vetëm në veçoritë teknologjike të mediave sociale por përmbledh edhe një analizë të konteksteve sociale, politike dhe ekonomike, brenda të cilave janë shfaqur këto media.					
Objektivat		Praktika profesionale synon përgatitjen profesionale brenda linjës së shkencave të komunikimit; Studentët do të aftësohen në përgatitjen, kërkimin dhe trajtimin e një ccështjeje; Studentët do të praktikojnë realizimin e intervistave në fushën e komunikimit; Studentët do të marrin aftësi praktike për të përgatitur artikuj të ndryshëm, reportazhe, njoftime për shtyp, si dhe analiza në fushën e komunikimit.					
Konceptet Kryesore		• Media sociale • Rrjete sociale • Ekonomizimi i rrjeteve sociale • Lojërat Online • Trollet • Lajmet e rreme					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje, prezantimi i lëndës Njohja me konceptet bazë të mediave sociale. Kategorizimi dhe dallimi i koncepteve që lidhen me mediat sociale. Prezantimi i lëndës dhe i sylabusit, zërat me të cilët studentët do të vlerësohen. Gjithashtu, gjatë kësaj jave studentët njihen me literaturën e cila do të jeta bazë për gjatë lëndës, si edhe literaturën e cila do të jetë mbështetëse.						
2	Të kuptojmë mediat sociale Në këtë leksion trajtohet fillimisht koncepti i mediave sociale dhe lidhja e tyre me shoqërinë dhe teknologjinë. Më tej leksioni merr në trajtesë grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre. Hjorth Laritha, Hinton Sam, “Understanding Social Media”, botimi i dytë (Sage Publications 2019) fq 13-24						
3	Ekonomia e mediave sociale Ky leksion trajton rritjen e organizimit ekonomik të shoqërisë që lidhet me rritjen e mediave sociale, krahasimi mes kapitalizmit informativ dhe kapitalizmit industrial. Leksioni trajton ekonominë politike të industrisë së mediave të reja, ku produkti i mediave të reja është i dominuar nga kompanitë e mëdha, por ajo gjithashtu zgjerohet në disa industri duke përfshirë argëtimin, pajisjet kompjuterike, pajisjet e rrjetëzuara, shitjet online, produktet softuer dhe telekomunikacionin. Hjorth Laritha, Hinton Sam, “Understanding Social Media”, botimi i dytë (Sage Publications 2019) Fq 55-69						
4	Pajisjet mobile Në këtë leksion do të trajtohet lidhja që ekziston ndërmjet mediave sociale dhe pajisjeve hardware. Në mënyrë kritike do të analizohet vazhdimësia dhe ndryshimet në rrjetet sociale si rezultat i ekzistencës së pajisjeve hardware. Më tej do të trajtohen efektet pozitive dhe negative të mediave sociale në shoqëri. Hjorth Laritha, Hinton Sam, “Understanding Social Media”, botimi i dytë (Sage Publications 2019) Fq 71-84						
5	Vizualizimi i mediave sociale Përgjatë këtij leksioni do të trajtohen çështjet vizualizimit në Facebook, Instagram dhe TikTok. Më tej do të analizohet pjesëmarrja digjitale si koncept i pandashëm në përdorimin vizual. Në leksion do të diskutohetn edhe rolet që kanë përkatësia klasore në shoqëri duke u kuptuar si prejardhje dhe shkollim, mosha, stili i jetës ose gjenerata, gjinia dhe përkatësia etnike në vizualizimin e mediave sociale Hjorth Laritha, Hinton Sam, “Understanding Social Media”, botimi i dytë (Sage Publications 2019) 99-107						

6	Lajmet e rreme në mediat sociale Gjatë këtij leksioni do të trajtohen konceptet e dezinformimit, çinformimit dhe keqinformimit. Leksioni trajton llojet e abuzimit në mediat sociale të tilla si: varësia, bullizmi kibernetik dhe trolling. Sapiera Eugenia, "Understanding New Media", botimi i dytë (Sage Publications 2018), fq 91-112
7	Influenca e Mediave Sociale dhe promovimet
8	Provimi gjysmë final
9	Arti i socializimit në mediat sociale Në këtë leksion trajtohen konceptet e socializimit dhe ndryshimit të mënyrave se si ne lidhemi me të tjerët. Gjithashtu, leksioni shpjegon nevojën e pashmangshme për t'u lidhur me të tjerët dhe për të qenë pjesë e komuniteteve globale. Përgjatë leksionit do të elementët e botës reale dhe asaj virtuale. Hjorth Laritha, Hinton Sam, "Understanding Social Media", botimi i dytë (Sage Publications 2019) Fq. 109-129
10	Media Sociale dhe demokratizimi i informacionit
11	Mediat sociale dhe realiteti miksi Gjatë këtij leksioni trajtohen ndryshimet që sjellin mediat sociale në perceptimin e shoqërisë rreth fenomeneve të caktuara. Përgjatë leksionit analizohet ndikimi i lojërave si Pokemon Go në stilin e jetesës dhe organizimin e saj. Hjorth Laritha, Hinton Sam, "Understanding Social Media", botimi i dytë (Sage Publications 2019) Fq 161-169
12	Mediat Sociale dhe Marketingu
13	Industria e lojërave online Në leksion shpjegohen lojërat si element kulturor, lojërat si cybertekst, dhe zhanret e lojërave: imituese, strategjike, aksion, role-playing, sandbox, të kombinuara. Narrativa e lojërave është e ndërtuar në "ne" dhe "ata", por do të shihet që në pikëpamjen semiotike, lojërat ndërmjetësohen nga praktika. Sapiera Eugenia, "Understanding New Media", botimi i dytë (Sage Publications 2018), fq 231-252
14	Media Sociale dhe jeta politike
15	Prezantim projektsh
16	Final Exam
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura Hjorth Laritha, Hinton Sam, "Understanding Social Media", botimi i dytë (Sage Publications 2019)	
Referenca të tjera - Lingren Simon, "Digital Media and Society", (Sage Publications 2017) - Fuchs Christian, "Social Media: A Critical Introduction", botimi i dytë (Sage Publications 2017)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të njohin konceptet që lidhen me mediat sociale
2	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi rolin e mediave sociale dhe ekonomizimin e tyre.
3	Studentët do të jenë të aftë të aplikojnë njohuritë e marra rreth mediave sociale, mediave online, algoritmeve, të dhënave dhe mediave digjitale.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	20	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	2	2
Gjysmë finale	1	1	1
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			79
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.16
ECTS			3.00